



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr 98/44 Prot

Tiranë, më 08. 06. 2020

Lënda: Dërgohet "Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit"

Drejtuar: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

TIRANË

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Z. Gazmend BARDHI

Adresa: Blv. "Zhan D'Ark, nr. 11,

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës nr. 6 prot., datë 16.01.2020, të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Gazmend BARDHI si dhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin "Për miratimin e rezultateve të verifikimit", të subjektit deklarues, **Agron Rufat MALAJ**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Mat.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI PËRGJITHSHËM

OLSIAN CELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL  
SEKTORI I DEKRIMINALIZIMIT

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT PËR SUBJEKTIN  
AGRON RUFAT MALAJ**

Në Tiranë, sot më 08. 06. 2020.

Unë Sokol STOJANI, me detyrë Drejtor/Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 17/2016, shqyrtova aktet e verifikimit nr. 98 Prot., datë 16.01.2020, të subjektit **Agron Rufat MALAJ** dhe në përfundim,

K O N S T A T O V A :

1. Subjekti Agron Rufat MALAJ është zgjedhur Kryetar i Bashkinë Mat, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 (i ndryshuar) ka plotësuar në datë 14.05.2019, Formularin e Vetëdeklarimit.
  - 1.1 Në pyetjen 1, të formularit të deklarimit, "A jeni dënuar me vendim të formës së prerë, nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj?", subjekti është shprehur se: ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Mat me vendimin nr. 57, datë 07.10.1999, për veprën penale të "Armëmbajtje pa leje" dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal është dënuar me 10 (dhjetë) muaj burgim.
  - 1.2 Në pyetjen të Formularit të vetëdeklarimit "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale", subjekti është shprehur se: ka qenë nën hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për ngjarjen e 21 Janarit 2011, nga data 11.01.2011 deri në 14.01.2011. Në datë 20.04.2011, Prokuroria ka vendosur pushimin e hetimeve.

Në pyetjen 5, të Formularit të vetëdeklarimit "A është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi apo jo?" subjekti është shprehur se ka patur në ngarkim të tij një masë shtrënguese e sigurisë personale "Arrest në burg", e cila është revokuar. Tek rubrikat ku duhen shënuar në mënyrë të specifikuar, subjekti ka shkruar se ka patur masën e sigurimit detyrim për paraqitje (data 14.01.2011-20.04.2011) të caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të parashikuar nga neni 248, 79 e 25 i Kodit Penal.

- 1.4 Nga aktet e administruara rezulton se, në vitin 2016, periudhë gjatë së cilës shtetasi Agron Rufat MALAJ, ushtronte detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Burrel, Departamenti i Administratës Publike (DAP), ka kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme që të kryejë verifikim të detajuar të të dhënave të deklaruara nga ai. Kjo praktikë është regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. 3197 prot, datë 25.10.2016, dhe si akt verifikimi me nr. 553/2016.
- 1.5 Në përfundim të verifikimeve të kryera lidhur me këtë kërkesë të DAP, me datën 20.04.2017, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë vendimin "Për miratimin e rezultateve të verifikimit të subjektit Agron Rufat MALAJ", sipas të cilit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se ky subjekt është i dënuar me 10 (dhjetë) muaj burgim sipas vendimit nr. 57, datë 07.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Mat, për veprën penale të "Armëmbajtje pa leje", parashikuar si krim nga neni 278/2 të Kodit Penal dhe se, subjekti përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, gërma "ç" të ligjit nr. 138/201, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
- 1.6 Vendimi i mësipërm prokurorisë "Për miratimin e rezultateve të verifikimit të subjektit Agron Rufat MALAJ" datë 20.04.2017, i është përcjellë brenda afatit ligjor Departamentit të Administratës Publike (DAP), si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga ligji nr. 138/2015 dhe nenet 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për të shqyrtuar dhe vendosur për faktin nëse të dhënat e evidentuara përfshihen në sferën e kufizimeve të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 dhe nëse ato janë brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të po këtij ligji.
- 1.7 Lidhur me vendimin e autoritetit përgjegjës për rastin, me shkresën nr. 2324/1/prot., datë 05.06.2020, Departamenti i Administratës Publike (DAP), ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme informacionin sipas të cilit rezulton si më poshtë :
- 1.7.1 DAP në cilësinë e organit përgjegjës për administrimin e formularëve të vetëdeklarimit për subjektet e përcaktuara në shkronjën "gj", të pikës 4, të kreut II, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë<sup>1</sup>, mbasi i është komunikuar nga Prokuroria e Përgjithshme vendimi "Për miratimin e rezultateve të verifikimit të subjektit Agron Malaj", ka zbatuar procedurën, duke i përcjellë informacionin institucionit përkatës në të cilin kandidon apo është emëruar subjekti.

<sup>1</sup> Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Bazuar në pikën 4, të nenit 4 të ligjit nr. 138/ 2015, për personat e dënuar për kryerjen e një krimi që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, sikurse në rastin e subjektit z.Malaj, ndalimi i ushtrimit të funksionit publik zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Në përfudim të shqyrtimit të rastit, organi përgjegjës DAP konstatoi se, për subjektin vetëdeklarues z.Agron Rufat MALAJ, në pozicionin e Drejtorit Rajonal, Drejtoria Rajonale Burrel, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ka përfunduar periudha e ndalimit për ushtrimin e funksionit publik, sipas ligjit nr. 138/ 2015, i ndryshuar, pasi ky subjekt është rehabilituar, siç dhe provohet nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 02.05.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

**Të dhënat mbi bazën e të cilave është iniciuar procesi verifikimit të plotë nga Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme.**

2. Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 6 prot., datë 16.01.2020, bazuar në pikën 3 të kreut V të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme që të kryejë verifikim të plotë të të dhënave të vetëdeklaruarra, prej subjektit Agron Rufat MALAJ në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Kërkesa është regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. 98 prot., datë 16.01.2020.

3. Në kërkesën e saj Partia Demokratike e Shqipërisë ka pretenduar si më poshtë:

3.1 Subjekti Agron Rufat Malaj është dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Mat, me vendimin nr. 57, datë 07.10.1999, për veprën penale të "Armëmbajtje pa leje" dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal është dënuar me 10 (dhjetë) muaj burgim.

Me këtë dënim, sipas kërkuarit, ky subjekt përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, gërma "ç" të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi ai është dënuar për një veprim që parashikohet aktualisht si vepër penale nga paragrafi 5 i nenit 278 të Kodit Penal (mbajtjen e armëve pa lejen e organeve kompetente shtetërore).

3.2 Referuar në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, kërkuarisi evidenton faktin se, subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje në mjedise publike. Ligji nr. 138/2015, i referohet veprimit të kryer, që korrespondon me anën objektive të veprës penale "armëmbajtja pa leje në ambiente publike", që përfshihet në ndalimet e nenit 2, pika 1, shkronja "a" e ligjit. Ndërkohë që ka lënë jashtë fushëveprimit të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 2 të ligjit "mbajtjen pa leje të armëve në banesë".

... që legjislatori në ligjin nr. 138/2015 i referohet veprimi apo mosveprimi, pra në objektive të veprës penale, dhe jo gjuhës dhe numërtimit të veprës penale, lidhet me faktin se Kodi Penal shqiptar ka pësuar ndryshime ndër vite si dhe faktit që ligji përfshin edhe dënimet e dhëna nga autoritetet e huaja, sipas Kodit Penal në shtetin përkatës.

#### **Verifikimi i kryer dhe rrethanat/fakti rezultuar:**

4. Lidhur me sa ka pretenduar dhe kërkuar Partia Demokratike e Shqipërisë, janë kryer verifikimet e nevojshme dhe deri tani ka rezultuar, si më poshtë:
  - 4.1 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën V.734/1, datë 25.01.2020, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin, "Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 17 prot., datë 25.01.2020". Sipas këtij akti shtetasi Agron Rufat Malaj rezulton me statusin "I dënuar", brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ku pasqyrohet se: "Me vendimin nr. 57, datë 07.10.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat e ka deklaruar fajtor për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe e dënon me 10 (dhjetë) muaj burgim. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal."
  - 4.2 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 592/1 prot., datë 04.02.2020, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit Agron Rufat MALAJ. Referuar këtyre të dhënave rezulton se: subjekti nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
  - 4.3 Gjykata e Rrethit Mat, me shkresën nr. 72 prot., datë 23.01.2020, ka paraqitur fotokopje të njëzuar me origjinalin të vendimit penal të formës së prerë nr. 57, datë 07.10.1999, nga shqyrtimi i së cilës rezulton si më poshtë:
    - 4.3.1 Të pandehurit Agron Malaj dhe E.D., Prokuroria e rrethit Mat, i kishte dërguar për gjykim nën akuzën se më datë 29.03.1999, rreth orës 11.00', në qytetin e Burrelit, pikërisht përpara mjedisit ku ushtronte aktivitetin e tij berberi K.K, pasi janë parë me të dëmtuarin nga vepra penale B.B., ata kanë shkëmbyer replika dhe shprehur pakënaqësi mes tyre për likujdimin e bërë më parë rreth një dëmi lidhur me një motoçikletë të dëmtuar, situatë e cila ka percipitur në grindje, momente në të cilën i pandehuri Agron ka nxjerrë pistoletën dhe e ka qëlluar të dëmtuarin Bashkim, duke plagosur atë në këmbë. Ndërkohë, i pandehuri tjetër E.D., ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar dhe ai lart në ajër, me synim për të parandaluar ndonjë ndërhyrje nga personat e pranishëm. Të dy të pandehurit i kanë patur armët pa leje të organeve kompetente dhe për këto fakte penale, janë akuzuar përfundimisht për veprat penale të "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" si dhe të plagosjes së lehtë me dashje" në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 278 paragrafi 2 dhe 89-25 të Kodit Penal të kohës, i cili ka ndryshuar në vijimësi.

Gjatë gjykimit, i dëmtuari nga vepra penale është shprehur se e tërhipte ankimin e tij dhe nuk kërkonte dënimin e të pandehurve për plagosjen në dëm të tij.

4.3.2 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Mat, me vendimin penal nr. 57, datë 07.10.1999, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Rifat MALAJ për veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake" dhe, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal dënimi i tij me 10 muaj burgim...
- Pushimin e gjykimit të çështjes në ngarkim të të pandehurve E.D. dhe Agron Malaj, për veprën penale të "Plagosjes së lehtë me dashje" në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 e 25 të kodit penal...

Ky vendim ka marrë formë të prerë datë 18.10.1999.

4.3.3 Në respekt të pretendimit të kërkuesve, lidhur me faktin kriminal për të cilin është deklaruar fajtor e dënuar subjekti Agron Malaj, konstatojmë se dispozita e kodit penal ka ndryshuar në vazhdimësi lidhur me veprën penale të "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit". Për një interpretim ligjor të drejtë, vlerësojmë se për të marrë kuptim argumenti, duhet të përmendet ligji i kohës dhe ai aktual. Kështu, në vitin 1999, periudhë kur dhe gjykohej çështja, ky fakt kriminal parashikohej në nenin 278, paragrafi i dytë i Kodit Penal të kohës, në këtë mënyrë: ***"Mbajtja e armëve, bombave apo minave, lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet."***

Në vijim, neni 278 i Kodit Penal është ndryshuar në paragrafët I, II dhe III, shtuar paragrafi IV me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 60; ndryshuar me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, neni 43; shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 98, datë 31.7.2014, neni 5; shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 135/2015, datë 5.12.2015, ndryshuar me ligjin nr. 82/2016.

Aktualisht, me ndryshimet e fundit ligjore, ky fakt penal parashikohet nga paragrafi i pestë i Kodit Penal, sipas të cilit parashikohet që: ***"Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, tregtimi dhe transportimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i armëve shpërthyesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet"***.

Lidhur me këtë, në kuptimin e ushtrimit të ndjekjes penale për fakte kriminale, siç dhe është ai për të cilin është dënuar subjekti në rastin konkret, prokuroria është kompetente dhe mund të japë vlerësimin e saj ligjor por, vetëm për sa i takon zbatimit të ligjit penal në hapësirë dhe kohë.

4.3.4 Kështu, referuar nenit 29<sup>2</sup> të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3<sup>3</sup> të Kodit Penal, si në gërmë ashtu dhe në frymë, parashikohet në thelb se autori i një veprë penale, duhet të dënohet sipas ligjit të kohës kur ka ndodhur fakti kriminal dhe, nëse ligji i kohës me atë të momentit të gjykimit janë të ndryshëm, do të zbatohen dispozitat më të favorshme për personin që akuzohet e gjykohet. Kjo do të thotë që, në rast se personi do të gjykohej sot për një fakt të tillë, pavarësisht se me ligjin në fuqi (aktualisht), nga ana objektive vepra parashikohet nga neni 278/5 i Kodit Penal, i ndryshuar, në rast se ndjekja penale nuk do të jetë parashkruar<sup>4</sup>, prokuroria do të ngrinte akuzë dhe do e dërgonte atë për gjykim për ligjin më favorizues, që do të thotë se duhet përgjigjej penalisht për nenin 278/2 i Kodit Penal të kohës kur ka ndodhur apo konsumuar krimi, pasi është padyshim një dispozitë më e lehtë se ajo aktualisht, çka e favorizon personin.

4.3.5 Parë në aspektin administrativ të çështjes, pra përsa i takon faktit nëse vepra penale për të cilën është dënuar etj subjekti deklarues, duhet të përfshihet ose jo në kufizimet parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", referuar frymës së këtij ligji dhe të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kjo është e detyrë e institucioneve përgjegjëse, që në rastin konkret i takon KQZ-së për të disponuar me vendim.

#### Neni 29 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.
2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.
3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

#### Neni 3 i Kodit Penal "Veprimi në kohë i ligjit penal"

Askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale.

Ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese. Në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, pushon.

Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.

#### Neni 66 i Kodit Penal, "Parashkrimi i veprës penale"

Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar:

- a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë;
- b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim;
- c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; ...

4.3.6 Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, në kuptim të këtij ligji është parashikuar të kontribuojë me ftesë të institucioneve përgjegjëse si KOZ, DAP, KED, Kuvendi i Shqipërisë etj, në rastet kur disponohen të dhëna që shërbejnë si indicie se mund të duhen hetime më të thelluara administrative të cilat nuk mund t'i bëjnë dot vetë.

Në këtë mënyrë shfrytëzohen kapacitetet dhe infrastruktura që ka institucioni i prokurorisë dhe marrëdhëniet e saj me autoritetet e drejtësisë vendase apo të huaja, etj. Ndaj dhe ligji e ngarkon prokurorinë si autoritet në ndihmë të institucioneve përgjegjëse dhe vetëm për verifikime të thelluara, në aspektin e veprimeve dhe jo të vendimmarrjes për themelin e çështjes administrative për të cilën ajo investohet me hetime, kompetencë kjo e cila i takon institucionit përgjegjës.

Prokuroria e Përgjithshme vendos se kur duhet të konsideruar i plotë hetimi administrativ dhe të miratojë rezultatet e veprimeve të kryera, duke i përshkruar ato me profesionalizëm dhe vërtetësi.

4 Në përgjigje të kërkesës sonë nr. 98/01, datë 22.01.2020, referuar informacionit të përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme, nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore (përveç asaj të Matit dhe Tiranës), Prokuroritë e Apelit dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), rezulton se shtetasi Agron Rufat MALAJ nuk është ndaluar apo arrestuar për kryerjen e ndonjë veprë penale dhe nuk i është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale.

4.4.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me shkresën nr. 99/1 Prot, datë 24.01.2020, ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme fotokopje të njehsuar me origjinalin të:

- Fashikullit të procedimit penal nr. 39/1999, si dhe Vendimin nr. 57, datë 07.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Mat, bashkëngjitur Urdhërin për ekzekutimin e këtij vendimi. Referuar akteve të këtij procedimi rezulton se, shtetasi Agron Mala është arrestuar në flagrancë nga policia më 31.03.1999. Sipas vendimit për "vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit", rezulton se më datë 01.04.1999, ndaj të pandehurit Agron Mala, gjyqtari i çështjes ka vendosur: Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg".

- Fashikullin e kallëzimit penal nr. 94, datë 11.04.2019. Referuar këtij fashikulli rezulton se, lidhur me kallëzimin e shtetasit Dritan Pjeçi, i cili ka kërkuar ndjekjen penale ndaj shtetasve S.TH. dhe Agron Malaj, më datë 22 Prill 2019, prokuroria ka vendosur: "Mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. 94/2019.



4.4.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 971/1 prot, datë 19.02.2020, ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme fotokopje të njehsuar me origjinalin të vendimit të pushimeve të procedimit penal nr. 285, të vitit 2011, në ngarkim të shtetasve Agron Malaj dhe A.A. (Ngjarja e 21 janarit e deklaruar nga subjekti.) Nga shqyrtimi i saj rezulton se:

Ndaj shtetasit Agron Rifat Malaj janë marrë masa sigurimi personal me karakter shtrëngues në dy momente gjatë fazës së procedimit penal. Kështu, me vendimin nr. 261 akti, datë 11.02.2011, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, ka caktuar si masë sigurimi ndaj shtetasit Agron Malaj, atë të "arrestit në burg" me afat 30 ditë, parashikuar nga nenet 238 dhe 245/ç të K.Pr.Penale, ndërsa me vendimin nr. 261/1 akti datë 14.02.2011, në momentin e verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, ajo ka zëvendësuar masën e arrestit, duke i caktuar si masë sigurimi atë të detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

4.5 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Instituti i Policisë Shkencore me shkresën nr. 536/1 prot, datë 04.02.2020, ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme informacionin si më poshtë: *".....në datën 04.02.2020 u paraqit pranë Institutit të Policisë Shkencore shtetasi Agron Rufat Malaj, i cili depozitoi gjurmët e gishtave të tij në një kartelë daktiloskopike marrë me bojë me ngjyrë të zezë. Nga ana jonë gjurmët e gishtave të këtij shtetasi u kërkuar në sistemin automatik të identifikimit të gjurmëve të gishtave AFIS dhe rezultoi se në këtë databaza ka dy kartela daktiloskopike me gjurmë gishtash identikë. Këto dy kartela janë në emër të shtetasit: në të dyja rastet, Agron Rufat Malaj. Njëra nga kartelat ka datën e marrjes 31.03.1999 dhe vendmarrje në Mat dhe kartela e dytë ka datën e marrjes në Tiranë, më 11.02.2011. Kjo kartelë daktiloskopike ka dhe numër të rregjistrimit kriminal që është: 20110221019, çka do të thotë që ky person është ndaluar/arrestuar në datën 11.02.2011, në Tiranë."*

4.6 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Departamenti i Policisë Kriminale), me shkresën nr. 2011/1 prot., datë 03.02.2020, na informon se, pas verifikimeve të kryera rezulton se për shtetasin Agron Rufat MALAJ nuk ka të dhëna në ndjekje për veprimtari kriminale si dhe ky shtetas nuk ka qenë i ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit. Gjithashtu, nuk ka gjeneralitete të tjera të regjistruara për këtë shtetas, përveç sa është deklaruar më sipër.

4.6.1 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, me shkresën nr. 1640/k KL/1 prot. JB-26/2020, datë 17.02.2020, informon se: "Nga verifikimet e kryera në arkivin e zyrës dhe në sistemin e kërkimit, nuk rezultojnë të dhëna për këtë shtetas deri më datë 17.02.2020.

4.7 Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se subjekti Agron Rufat Malaj ka të njëjtat gjeneralitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Në sistem nuk rezulton të jetë ndonjë person tjetër me këto të dhëna dhe Agron Rufat Malaj nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Për sa më sipër, në mungesë të indicieve apo të dhënave që do të justifikonin një verifikim për jashtë shtetit, si dhe pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, duke i konsideruar këto verifikime të plota, bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1, 2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe në përcaktimet e pikës 3, gërma "ç", Kreu III-të dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit Nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

### V E N D O S A :

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit në lidhje me subjektin **Agron Rufat MALAJ** person ky i zgjedhur Kryetar i Bashkinë Mat, si më poshtë:
  - 1.1 Rezulton të jetë i dënuar me 10 muaj burgim me vendimin nr. 57, datë 07.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Mat, për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal i kohës.
  - 1.2 Rezulton që më datë 31.03.1999 të ketë qenë "arrestuar në flagrancë", sipas nenit 251 të Kodit të Procedurës Penale, nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë së Matit, në funksion të procedimit penal nr. 39/1999, ku ka qendruar me këtë status deri më datë 01.04.1999, ditë kur Gjykata e Rrethit Mat ka vendosur për marrjen e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "arrest në burg" sipas nenit 238 të K.Pr.Penale dhe në vijim, është deklaruar fajtor e dënuar me 10 muaj burg nga po kjo gjykatë, me vendimin nr. 57, datë 07.10.1999, për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal i kohës.
  - 1.3 Rezulton që nga gjykatat shqiptare të jenë vendosur ndaj tij masa sigurimi personale me karakter shtrëngues në dy raste dhe konkretisht:
    - i. Me vendimin e datës 01.04.1999, Gjykata e Rrethit Mat ka vleftësuar si të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe ka caktuar si masë sigurimi ndaj shtetasit Agron Malaj "arrest në burg", sipas nenit 238 të K.Pr.Penale, në kuadër të procedimit penal nr. 39/1999, të regjistruar nga prokuroria pranë kësaj gjykate.

ii. Më datë 11.02.2011 është zbatuar nga policia gjyqësore e Drejtorisë së Policisë së Tiranës, në funksion të procedimit penal nr. 285/2011, vendimi nr. 261 akti, datë 11.02.2011, i Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka caktuar si masë sigurimi ndaj shtetasit Agron Malaj, atë të "arrestit në burg" me afat 30 ditë, parashikuar nga nenet 238 dhe 245/ç të K.Pr.Penale.

Pas 3 ditësh, me vendimin nr. 261/1 akti, datë 14.02.2011, në momentin e verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, e njëjta gjykatë ka zëvendësuar masën e arrestit, duke i caktuar atij si masë sigurimi atë të "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

4 Rezulton të ketë patur një kallëzim ndaj tij të regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Mat me nr. 94, datë 11.04.2019. për të cilin më datë 22.04.2019, prokurori ka vendosur: "Mosfillimin e procedimit penal".

5 Nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile;

6 Pavarësisht se në vendimet gjyqësore të ndryshme evidentohet herë me emrin Agron Rufat Malaj dhe herë tjetër me emrin Agron Rifat Mala, nisur nga të dhëna si amësia, datëlindja apo krahasimi i gjurmëve të gishtave, dilet në përfundimin se kemi të bëjmë me të njëjtin person.

7 Nuk rezulton të ketë indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion, me qëllim kryerje verifikimi, për:

- veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë,
- urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij,
- marrjen e ndonjë mase dëbimi ndaj tij,
- përdorimin e gjeneraliteteve të tjera;

Ky vendim mbi rezultatet e verifikimit t'i njoftohen brenda 3 (tre) ditëve Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili si organ kompetent në zbatim të nenit 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, duhet të shqyrtojë nëse janë evidentuar të dhëna që përfshihen në sferën e kufizimeve të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 dhe në vijim, të vlerësojë nëse ato janë brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të po këtij ligji.

Rezultatet përfundimtare të verifikimit t'i njoftohen dhe subjektit "Partisë Demokratike të Shqipërisë", e cila ka paraqitur kërkesën për verifikim të subjektit Agron Rufat Malaj.

PROKURORI

